



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 1743 Prot.,

Tiranë, më 07.05.2024

VENDIM

Nr. 2, datë 07.05.2024

“PËR
“MIRATIMIN E MODELIT TË FORMULARIT TË ANKESËS SË NËPUNËSIT
CIVIL GJYQËSOR”

Këshilli i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, në mbledhjen e tij të datës 07.05.2024, bazuar në nenet 27, 28, 38 dhe 69 e vijues të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”, në nenet 9, 10, 16 të vendimit Nr. 71, datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës”, dhe vendimit Nr. 22, datë 24.01.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit civil gjyqësor”,

V E N D O S I:

1. Miratimin modelit të formularit të ankesës së nëpunësit civil gjyqësor pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Ngarkohet nëpunësi i IT-së të bëjë publikimin e modelit të formularit të ankesës së nëpunësit civil gjyqësor në faqen zyrtare të gjykatës me qëllim lehtësimin e paraqitjes së ankesave.
3. Ngarkohet Kancelari të marrë masat në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I GJYKATËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLES SE PARE
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

FORMULARI I ANKESËS

I.

INFORMACION MBI TË DHËNAT PERSONALE TË ANKUESIT			
Emri Mbiemri i ankuesit:			
Nr. Personal / Shtetësia:			
Emri Mbiemri i Përfaqësuesit të personit Juridik:			
Adresa e përhershme:			
Adresa për korrespondencën (nëse është e ndryshme nga adresa e përhershme)			
Adresa elektronike (e-mail)			
Numrat e telefonit	Nr. Fiks	Punë / Zyrë	Celular
Forma e ankesës	☐ Me postë elektronike		☐ Personalisht
	☐ Me postë të rregullt		☐ Faks
Konfidencialiteti i identitetit	Kërkoni të ruani konfidencialitetin e identitetit tuaj? ☐ PO ☐ JO		

II.

INFORMACION MBI TË DHËNAT E SUBJEKTIT	
Subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa:	
☐ Nëpunësi civil gjyqësor	
Emri dhe Mbiemri i subjektit:	
Nëpunësi civil gjyqësor ushtron ose ka ushtruar në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar:	

III.

OBJEKTI I ANKESËS	
Shkelja disiplinore e pretenduar është:	
☐ në lidhje me ushtrimin e funksionit	
☐ jashtë ushtrimit të funksionit	
Cila është ankesa juaj? (Ju lutemi jepni detaje mbi faktet, rrethanat dhe datën se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar)	

IV.

LISTA E DOKUMENTAVE BASHKËLIDHUR
1.
2.
3.
4.
5.
6.

Data

Nënshkrimi i Ankuesit